


Porosia e
MUADH IBN XHEBELIT

Radij Allahu anhu



POROSIA E MUADH IBN XHEBELIT

RadijAllahu anhu

Trasmeton Muadh Ibn Xhebeli RadijAllahunahu, i cili thot;

Më ka porositur Pejgamberi, Sal-IAllahu alejhi we sem me dhjet fjal dhe më tha:

1. Mos i shoqëro Allahut askë në adhurim, Mos i bë shirk, edhe nëse vritesh dhe digjesh.
2. Kurrresi mos u bë i padëgjueshum ndaj prindëve të tu, edhe nëse të urdhërojnë të dalësh dhe të ndahësh nga familja dhe pasurija jote.
3. Asesi mos e le namazin e obligueshum me qëllim, ngase ai i cili e lë pa falur namazin që e ka farz me qëllim, mbrojtja e Allahut ndaj tij tanëmë është larguar.
4. Kurrresi mos pi verën, ngase ajo është kreu i gjdo të keqe.
5. Të keshë kujdes nga mëkati, s'pse mbi të lëshohet hidhrimi i Allahut.
6. Mos ik prej frontit të luftës edhe nëse shkatërrohen të gjithë njerzit.
7. Kur t'i godasë njëri vdekja prej mortajes, duke qenë ti në mesin e tyre, qëndro mos ik prej saj e të mbartësh atë edhe në vende të tjera.
8. Furnizoje familjen tënde nga mundesit e tua.
9. Mos e ngre prej tyre thupëren e mej rahë për shaka edukimit.
10. Dhe bëji ata të kanë frikë Allahun." Trasmeton Buhariu.

POROSIA E PARË: Mos i shoqëro Allahut askë, edhe nëse vritesh dhe digjësh...."

Pejgamberi Salallahu aljehi we sel-lem fillojë ta porosis Muadhin RadijAllahu anhu, duke e ndaluar atë t'i bëj shirk Allahut Subhanehu we te A'la, ngase shirku është mëkati më i madhë.

Thotë Allahu subhanehu we te A'la në porosin e Lukmanit duke i dhënë birit të tij:

" O biri im, mos i shoqëro Allahut diqka në Adhurim, vërtet shirku është padrejtisia më e madhe." Lukman,13

Poashtu thot:

" Allahu nuk e fal atë që Atij t'i shoqërohet diqka në Adhurim dhe i falë përveq asaj atij që Ai dëshiron." En-Nisa. 48

Po ashtu thot:

" Dhe ai që i bën shirk Allahut ka shpifur një mëkat të madhë". En-Nisa,48.

Gjithë ashtu thot:

" Dhe ai që i shoëron Allahut edhe diqka tjetër tashmë ka humbur një një humner të largët". En-Nisa,116.

Gjithë ashtu thot:

" Ai që i shoqëron diçka Allahut në Adhurim tashmë i'a ka bërë atij Allahu haram Xhennetin e vendëbanimi i tijë është zjarri, dhe për zullumqarët nuk ka ndihmtarë". El-Maide,72.

Gjithë ashtu thot:

" Ai që i bën shirk Allahut është sikur të bije dhe të përplaset nda qielli e ta rrëmbejë shpendi ose sikur ta përplas era e stuhishme në ndonjë vend të humbur.". El-Haxh,31.

Kur u pyet Pejgamberi SalAllahu alejhi we sel-lem cili është mëkati më i madhë tha: " Të i bësh Allahut shok, kurse Ai të ka krijuar."

Ndërsa në hadithin e Muslimit thuhet për një grua nga beni israiët e afruan që ta hedhin në zjarrin e hendeqve të tyre, në mënyrë që të largohet nga feja e saj se përndryshe do të digjët, ndërsa ajo mbante foshnjën që i dhibstej po të hynte në zjarr. Por Allahu e bëri foshnjën e saj që të flasë nënës duke i thënë: " Oj nënë, duro, sepse ti je në hak në rrugë të drejtë". Muslimi

Po ashtu ngjarja e Ibrahimit alejhi selam, të cilin populli i tijë e murrën dhe e hishën në zjarrë.

Thot Allahu subhanehu we te A'la,

" Ata than: Digjeni atë dhe ndihmoni zotat tuaj, në qoft se e bëni një gjë të tillë!, Ne i tham: O zjarrë, bohu i ftoht dhe shpetim për Ibrahimin". El-Enbija,68-69.

Nga Habbab Ibn Eretti RadijAllahu anhu trasmetohet se ka thënë:

U ankuam te Pejgamberi sal-Allahu alejhi we sel-lem, derisa ishte i mbeshtetur në hijen e Qabes dhe i than: " A nuk po kërkon ndihm për ne tek Allahu ? A nuk po lutësh për ne ? Pejgamberi Sal-lAllahu alejhi we sel-lem tha: " **Ka pasur para jush të tillë kur merrej njeriu dhe i hapej atij një gropë në tokë e pastaj e futnin në të dhe trupin e tij e grryeshin me krehër të hekurit, me gjith mishin dhe ashtin e tij, dhe kjo nuk e largonte atë nga feja e tij, por ju po nguteni'** Buhariu.

Kështu e ngjajëshme i ka ndodhur Bilalit Radijallahu nahu, Kur e pranojë Islamin dhe ai i cili e kishte robu Bilalin, ndegjojë se Bilali është bër Musliman dhe është në fen e Muhammedit Sal-lAllahu aljehi we sem, dhe e murren dhe lidhën me litar dhe fulluna ta ngrihin zhagas për shkretin deri te vendi i nënshkimit, dhe morrën dhe i qitën një guri të madh në barkun e tij, që të i vështërohet gjendja e tij, dhe e urëdhronin që të dal prej dinit të Muhamedit Sal-lAllahu alejhi we sel-lem, por ai RadijAllahu anhu nuk u derzua por thojke: **Allahu është një, Allahu është."**

Pejgamberi Sal-lAllahu alejhi we selm, Ka than:

" **Pasha Allahun, gjithësesi Allahu do ta plotsojë këtë qështje Islamin, Saqë kalorsi do të udhëtojë prej Sanasë e deri në Hadremeut dhe nuk do t'i friksohet askujt përveq Allahut dhe ujkut për delet e tij, por ju po nguteni."** Buhariu.

E t'i bëshë shirk Allahut do të thotë: t'ia kushtosh të drejten e Allahut dikut tjetër përveq Tij, që është padrejtësi dhe shpifje e kulluar.

Prejë formave të shirkut është:

1. Rrotullimi rreth varreve.
2. Të kërkosh ndihmë nga të vdekurit.
3. Falli, Horoskopi,parashikimi i fateve të njëzve përmes tyre Etj.....

POROSIA E DYTË

".... Dhe kurrësesi mos u bë i pa dëgjueshm ndaj prindërve të tu, edhe nëse të urdhërojnë të dalësh dhe të ndahësh nga familja dhe pasuria jote...."

Allahu Subhanehu we te A'la thotë për drejtat e prindërve.

" E nëse ata përpiqën që ti të më shoqërosh dikë Mua e për të cilën gjë ti nuk ke dituri, atëher mos iu nënshtro atyre dhe shoqëroji ata në këtë bot me mirësi." Lukman,15

Gjithë ashtu thotë:

" U ka ndaluar juve Zoti juajë: që Atijë asgjë të mos i shoqëroni dhe me prindër mirë të silleni". En- Am,151.

Nërsa Ebu Bekrete Radijallahu anhu thot: Ka than Pejgamberi Sal-IAllahu alejhi we selm,

" A dëshironi t'ju tregojë për mëkatin më të madhë ? Kët e përseriti tri herë, kurse ne i tham: Gjithsesi, E ai tha: " T'i bësh shirk Allahut dhe të jesh i pa dëgjueshum ndaj prinërve të tu.

Buhariu & Muslimi.

Gjith ashtu Ka thën: " Ti dhe pasurija jote jeni të babait tënd".

POROSIA E TRET:

....dhe asesi mos e le pa e falur namazin e obligueshum me qëllim, ngase ai që e lë pa e falur namazin, që e ka farz, me qillim, mbrojtja e Allahut ndaj tij tanimë është larguar..."

Qëllimi i kësaj porosije është përkujdesja dhe ruajtja e namazit të obligueshum, d.m.th. Që është farz. E sa të shumta janë porosit për namazin në Kur'an dhe Sunnet !

Allahu Subhanehu we te A'la thot:

" Vërtet Namazi është obligim për besimtarët..... ". En-Nisa, 103.

Gjithë ashtu thot:

" Urdhëroje familjen tënde ta fal namazin, edhe ti vet bëhu i qëndrueshum në zbatimin e tij....". Taha,132.

Po ashtu thot:

" Falne namazin, vërtet namazi ndalon nga gjdo e keqedhe e shumtuar dhe permendja e Allahut është e madhe....". Al-Ankebut, 45.

Po ashtu thot:

" Kujdesuni rregullisht për namazet....". El Bakere, 238.

Po ashtu thot:

" O ju që keni besuar, kërkoni ndihmë me durim dhe namazë...". El Bakera, 153.

Pejgamberi Sal-IAllahu alejhi we sel-lem, kur e mundonte ndonjë gjë, strehorej në namaz. Ai ka than:

" Marrveshja midis nesh dhe mis tyre është namazi, pra ai që e le ka bër kufër (ka ra në pabesim). Termidhiu

Pra kush e le namazin me qillim është larguar mbrojtja e Allahut na vetja e tij.

POROSIJA E KATËRT:

.... Dhe kursesi mos e pi verën..."

Thot Allahu Subhanehi we te A'la

" O ju që keni besuar, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetave për fall, janë vepra të ndyra të djallit, Prandaj, largohuni nga ato që të jeni të shpetuar. "

Po ashtu thot:

" Shejtani nuk deshiron tjetër përveq nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedh armiqësi midis jush, t'ju largojë nga të përmendurit e Allahut dhe nga namazi. Pra, a po i jepni fund ?." Maide,90-91.

Pejgamberi Sal-lallahu alejhi we sel-lem, Tashmë e ka mallkuar verën, : Pirsin e saj, shërbyesin e saj, shitsin dhe blersin e saj, ata që e ha fitim nga ajo, shtrydhsin, atë për të cilin shtrydhet, barsit dhe atë që bartet.

POROSIA E PESTË:

... Dhe ruaju nga mekati, sepse mbi të lëshohët hidhrimi i Allahut...."

Pejgamberi Sal-lallahu alejhi we sel-lem ka than:

" Të gjithë bijtë e Ademit janë gabimtarë, e më të mirët prejë ture janë ata që pendohen."

Po ashtu thot:

" Vërtet Allahu i ka bër të detyruara disa obligimi, i ka caktuar disa kufij, e mos i shkelni ato...."

Thot Allahu Subhanehu we te A'la

"Ata që mohuan të vërteten nga beni Israilet u mallkuan nga gjuha e Davudit dhe të Isaut, birit të merjemit, kështu, sepse ata kundërshtuan, ishin mekatar dhe e tepruan..." El-Maide, 78.

Po ashtu thot:

" Sa e keqe është ajo që ata e vepronin." El-Maide, 79.

Allahu Subhanehu neve si Ummet na ka vlertsu mbi të gjithë Ummetet tjera, Thot:

" Ju jeni Ummeti më i mir që është nxjerrë për të miren e njëzve, urdhroni për të mir dhe ndaloni nga e keqja, dhe besoni në Allahun." Ali Imran,110

Po ashtu thot:

"... Dhe të ishin ruajtur nga mëkatet, Ne do t'ua hapnim atyre bereqetet nga qielli dhe taka..." El-A'raf, 96

Po ashtu thot:

" Unë u thash atyre: Kërkoni falje Zotit tuaj, se Ai vërtet fal shumë, Ai ju lëshon nga qielli shi me bollak, ua shumon pasurin dhe familjen, ju furnizon me kopshte dhe me lumej." Nuh, 10-12.

Gjith Ashtu thot:

" Nëse largoheni nga ato mëkatet të mdha prej të cilave jeni të ndaluara, Ne do t'ua falim juve të tjerat mëkate....". Nisa,31

Ndërsa Pejgamberi Sal-IAllahu Alejhi we sel-lem ka than

" Allahu e ka hapur deren e pendimit tërsisht, ka bër që abdesi të i fal mëkatet, namazi të shlyen mekatet që bëhen në mes tyre, umreja deri në umre, xhumaja deri në xhuman i shlyejn mekatet e bëra në mes tyre".

POROSIA E GJASHTË:

"...Dhe mos ik prej frontit të luftës, edhe nëse shkatrrohën të gjithë njerzit..."

Trasmeton Ebu Hurejra RadijAllahun Anhu se Pejgamberi Sa-IAllahu alejhi ve sel-lem ka than: " Ruajuni prej shtatë gjërave që jan shkatrruese... dhe njëren prejë gjërave përmendi edhe ikja prejë frontit... ". Bahariu & Muslimi.

Thot Allahu Subhanehu we te A'la

" O ju që keni besuar, Kur të ndesheni me pabesimtarët në front, mos u a ktheni shpinen !".

Po ashtu thot:

" ... i tilli është këthyer me hidhrim nga allahu dhe vendi i tij është xhehnemi e sa përfundim i keq që është ai!". El-Enfal,15-16.

POROSIA E SHTATË:

".... Dhe kur t'i godasë njerzit vdekja prej mortajes, duke qenë ti në mesin e atyre, qëndro mos ik prej atij vendi e ta bartesh atë edhe në vende të tjera....".

Trasmeton Abdullah Ibn Abbasi RadijAllahu anhu se Omer Ibn Hatabi ka dal për në sham, deri kur erdhi te vendi i quajtur Serg, ku e takuan atë Ubejde Ibn Xharrah dhe shokt e tij, dhe e lajmruan për murtajen kishte rënë në sham. Ibn Abbasi tha: " Më tha Umeri: M'i thirr muhaxhirët e par, i tharra ata e ai i kundërshtoi e u tregoi de mortaja ka rënë në sham, kurse ata u kundërshtuan në mendim... pastaj i thirri ensarët, edhe ata u kundërshtuan, dërsa erdhi Abdurrahman ibn au fi RadijAllahu anhu i cili kishte munguar për disa nevoja te tija, dhe tha: Unë rrethë kësaj qështje kam dituri. E kam degjuar Pejgamberin Sal-lAllahu alejhi ve sel-lem se ka tha:

" Kur të dëgjoni se mortaja ka rënë në ndonjë vend, mos shkoni atje, e nese ajo ka rënë në ndonjë vend e ju gjinden në të, atëher mos dilni prej atje për të ikur nga ajo! Umeri e falenderoi Allahun dhe u kthye."

POROSIA E TETË:

... Dhe furnizoje familjen tënde nga mundesit e tua...".

Thot Allahu subhanhu we te A'la

" Ne do t'i furnizojm ata edhe juve." El_Isra, 31

Sad Ibn Ebi Vekkasi RadijAllahu anhu thot se Pejgamberi Sal-IAllahu alejhi we sel-lem ka than: " ...Kafshata që vendos në gojën e gruas tënde është **sadaka**". Buhariu & Muslimi.

Po ashtu ka than: " **Të shpenzosh për familjen tënde është sadaka**". Buhariu.

Ebi Mes'ud el-Bedri RadijAllahu anhu thot se Pejgamberi sal-IAllahu alejhi we sel-lem ka than: " Kur njeriu të shpenzon për familjen e tijë diqka duke e llogaritur tek Allahu shpërblim, ajo për të shkruhet **sadaka**". Buhariu & Muslimi.

Ebu Hurejre RadijAllahu anhu thot se Pejgamberi Sal-IAllahu alejhi we sel-lem ka than: " ... **Shpërblimin më të madh e ka ai dinar që e ka shpenzuar për familjen e vet**". Muslimi.

Ndërsa a'i që ka vështërsi për shpenzimin e tijë thot Allahu subhanehu we te A'la " **E pas vështërsis, Allahu do të sjell lehtësim**". Et-Talak, 73.

E sikur njeriu ta merrte këtë porosi të vendosur nga Pejgamberi sal-IAllahu alejhi we selem, do të shpetonin nga borgjet dhe kamatat me pak fjal ... **dhe furnizoje familjen tënde nga mundesit e tua**".

POROSIA E NËNTË:

"..... Dhe mos e nge prej tyre thupren për të i rrahë, që t'i edukosh...."

Kjo porosi ka të bëj me Ahlakun e Pejgamberit Sal-IAllahu alejhi we sel-lem, që ne të mirremi me të dhe të u'a mësojm edhe familjes sonë. Se si të edukohemi si te sillemi e tjer....

Pejgamberi Sal-IAllahu alejhi we sel-lem ka than:

" Urëdhroni fëmijët tuaj me namaz duke qen ata në moshën shtatë vjeqare, dhe rrihni ata duke qen në moshën dhjet vjeqare, dhe ndajeni ata në shtratër". Buhariu.

Kuptimi i rrahjes është goditja që nuk e lëndon, nuk e plagos, porse qëllimi është friksimi që ata ta ndijë fajin e vet.

POROSIA E DHJETË:

"..... Dhe bëri ata ta kan frik Allahun....".

Thot Allahu subhanehu we te A'la

" Dhe për atë që iu frigua Madhrisë së Zotit të tij ka dy xhennete." Er-Rahman,46.

Po ashtu thot;

" Dhe ai i cili pat frikën Madhrisë së Zotit të tij dhe ndaloi veten e tij nga epshi, për të Xhenneti do të jet vendbanim i tij." En-Naziat, 40.

Kjo perosi vlen për të gjithë ne jo vetëm për Muadhin RadijAllahu anhu por për të gjithë Musliman.

Dhe lutja jonë e fundit është: I tërë falenderimi i takon Allahut, Zotit të botrave.



Përgaditi: Ismet Hyseni
